



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



Adresa Rr 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër.

web. www.bashkiashkoder.gov.al,

e-mail keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al.

V E N D I M

Nr. 31, datë 30.5.2017

**Për dhënien e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme,
të shkaktuara nga zjarri**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.05.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 8, 9, 40, nenin 54 shkronja "dh", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika III/1/ shkronja "ë" të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore", udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKB nr.8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017", me 28 vota pro,

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Pavlin Gramshi**, meqenëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 4 (kater) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **80,000** (tetëdhjetë mijë) lekë.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Ramadan Çinari**, meqenëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e saj përbëhet prej 2 (dy) anëtarë dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
3. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Besnik Çinari**, meqenëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e saj përbëhet prej 3 (tre) anëtarë dhe ndihma financiare të jetë në shumën **60,000** (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

4. Burimi i financimit do të jetë fondi rezervë i bashkisë i parashikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2017 të miratuar me VKB nr. 8, datë 30.1.2017.
5. Institucionit të bashkisë Shkodër në programin buxhetor 10910 "Emergjencat Civile" ti shtohet kundërvlehtë në lekë e fondit prej 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë shpenzime korente –artikulli 606 "Transferta tek individë", për tu përdorur si shpërblim për rastet e fatkeqësisë.
6. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës 180,000 lekë.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.5.2017

Shpallur në datën 31.5.2017

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKU SHKODËR

Pr. 9156 dt. 14.6.2017

Nr.643/1Prot

Shkodër, më 12.06.2017

Lënda: Lidhur me vendimin nr.31, datë 30.05.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin", ligjit nr.139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", neni 29, neni 64, germa c, 40, 54/dh, 55/3 ligjit nr.8756,dt. 26.03.2001 "Per emergjencat civile", i ndryshuar; ligjit nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor", i ndryshuar, VKM nr.329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmes ekonomike shtetërore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njezore" kreu III, pika 1, germa "ë", Udhezimit te Perbashket te MPB dhe MF Nr.263 dt.24.05.2013 Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktura nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktura nga veprimtaria njezore", ligjit nr.44/2015 KPAD, neni 56/4, analizoi vendimin nr.31, datë 30.05.2017 të Këshillit Bashkiak Shkodër "Per dhënie ndihme financiare familjes së z. Pavlin Gramshi në shumën 80.000 leke për djegie banese (procesverbal konstatimi dt 28.4.2017 i komisionit teknik-administrativ), fshati Mushan, NJAD Dajç, z.Ramadan Çinari në shumën prej 40.000 lekë, për fatkeqësi (djegie) bashkia Shkodër(qytet) dhe z. Besnik Çinari në shumën prej 60.000 lekë, për fatkeqësi (djegie) bashkia Shkodër-qytet (sipas procesverbal konstatimi dt 18.4.2017 i komisionit teknik-administrativ) me burim financimi buxheti i vitit 2017-VKB nr.8/2017".

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni pasi është në të drejtën e të dëmtuarit të përfitojë ndihmën e menjëhershme nga NJQV sipas VKM nr.329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmes ekonomike shtetërore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njezore" kreu III, pika 1, germa "ë".

Me respekt,

PREFEKTI

